



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, më 17 prill 2013, në orën 10:00, salla N-302
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Ramiz Lladrovci, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Ramë Buja, Auditori i Përgjithshëm Lars Lage Olofsson.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatorë, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 03.04.2013.
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të analizimit të pengesave në implementimin e programit DANIDA, "Promovimi i punësimit të rinjës përmes biznesit dhe shkathhtësive zhvillimore 2008-2012".
4. Shqyrtimi i propozimit të deputetes Valbona Dibra, lidhur me kërkesën për Raport nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për menaxhimin e stafit në këtë institucion.
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 03.04.2013

Kryetari- Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi, njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 03.04.2013

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të analizimit të pengesave në implementimin e programit DANIDA, "Promovimi i punësimit të rinjtë përmes biznesit dhe shkathtësive zhvillimore 2008-2012"

Kryetari - Sipas një marrëveshje të mirëkuptimit të nënshkruar në mes Ministrisë së Punëve të Jashtme të Danimarkës dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës e cila është arritur në vitin 2007, me qëllim të promovimit të shkathtësive zhvillimore të rinjve në punësim, Sekretari i MASHT-it ka pasur rolin udhëheqës të Komitetit Drejtues të Komponentës (KDK) së kësaj komponente. Ai këtë kompetencë e ka transferuar të nivelet më të ulëta përbrenda MASHT-it, të cilat nuk e kishin autoritetin dhe përkrahjen institucionale të mjaftueshme. Me kërkesën e projektit të DANIDA është kërkuar të bëhet auditim me qëllim të hulumtimit të shkaqeve të vonësive në implementimin e projektit.

I tërë projekti ka qenë i përbërë nga tri komponent: Mbështetja për Agrobizneset; Përmirësimi i Punësimit për të Rinjtë; dhe Përmirësimi i qasjes në shërbimet financiare (vetë-menaxhimi). Fokusimi i auditimit ishte në pjesën e dytë të kësaj komponente e që kishte të bënte me përmirësimi e punësimit për të rinjtë. KDK-ja përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencia Kosovare e Agrobiznesit (AKA), Ministrisë së Punëve të Jashtme e Danimarkës (MPJ), si dhe nga Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional (KAAP), ndërsa udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it, Mandati i KDK-së është të mbikëqyrë implementimin e komponentës, përmes procesit të raporteve të progresit të nxjerra dy herë në vit nga Njësia Menaxhuese e Komponentës (NjMK). Meqenëse sekretari i përgjithshëm i MASHT-it ishte pozita koordinuese e projekti dhe se ndërrimet e shpeshta të kësaj pozitë kishin ndikim negativ në implementimin e kësaj komponente. Po ashtu probleme të theksuara kishte edhe në fushën e prokurimit të kësaj komponente, edhe pse sipas marrëveshjes parashihet që prokurimin ta kryej MASHT-i, kjo në praktik nuk ndodhi! Dy zyrtarët e kontraktuar nga MASHT-i nuk i kanë përcjellur deri në fund çështjet e prokurimit. Ndërsa të punësuarit në NJMK, nuk kishin përvojë të mjaftueshme në këtë fushë.

Në vitin 2011 marrëveshja u rishikuar dhe çështjet e prokurimit u transferuan në APP. NJMK ka pesë të punësuar: udhëheqësi i njësisë, këshilltari ndërkombëtar financiar, këshilltari ndërkombëtar për arsim dhe zhvillim, eksperti vendor bujqësor, dhe dy staf mbështetës në administratë dhe logjistikë.

Marr në përgjithësi rekomandimet e ZAP-it nuk kanë të bëjnë me ndonjë konstatim se këtu ka pasur shkelje materiale apo shkelje të procedurave. Mirëpo këtu kemi të bëjmë me vonesa të shumta në implementim të projektit dhe nga kjo rekomandimet janë adresuar në tri drejtime.

Ramiz Lladrovci - Në raport kemi parë disa mungesa. Disa për shkak të disa problemeve me Ligjin edhe me procesin financiar e disa si rezultat i ndërrimit të sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, ku pas një viti vonësë po realizohet ky program. Cila ka qenë shuma e përgjithshme e këtij projekti? Kjo nuk është paraqitur në raport! Po ashtu pyeti përfaqësuesin e Danidës se a është i kënaqur me punën e vetë projektit dhe a ka ndonjë vërejtje në raportin e Auditimit të ZAP-it?

Mursel Haljilji – U interesua për efektin e arritur të implementimit të këtij projekti në rininë e Kosovës, në momentin e përfundimit të projektit, në çështje së aftësimeve që do të marrin të rinjtë në sektorin e bujqësisë.

Imri Ahmeti – Në këtë raport vërehen problemet e menaxhimit të këtij donacioni përkatësisht ka probleme të mëdha në kuptimin e menaxhimit të prokurimit. Për shkak të këtyre problemeve duket që Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës ka kërkuar në vitin 2011, që procedurat e prokurimit të udhëhiqen nga Autoriteti Qendrorë i Prokurimit (AQP). Personat që kanë menaxhuar këto fonde, a ka ndërmarrë dikush ndonjë përgjithësi për këtë punë? Kjo sepse shihen që mjetet janë zotu pasi kanë mbërritur faturat nga operatorët ekonomik, nuk ka pasur përputhje me kriteret e shpallura. Ka mos nënshkrim të procesverbaleve nga personat kompetent, ka edhe elemente tjera që ka pas shkelje në menaxhimin e këtij fondi. Një shembull konkret nga përvoja ime. Në Lipjan ka qenë një investim i madh nga “Norgesvelli”, mirëpo në momentin e shkuarje së investitorit, projekti si i tillë ka mbetur pa menaxhim dhe pa mirëmbajtje adekuate dhe si i tillë po shkatërrohet.

Valbona Dibra – Tha se po flasim për një raport i cili nuk ka asnjë shifër se çfarë fondi është audituar dhe është për keqardhje që Komisioni ta ketë një raport jo profesional. Në të vërtetë Raporti nuk pasqyron asgjë. Në asnjë pikë të Raportit nuk përcaktohet shuma e fondit të audituar. Gjithë Raporti flet për fondin dhe në asnjë pikë nuk përmendet shuma e mjeteve të ndara. Pjesa e raportit të ka të bëjë me prokurimin është e pakuptimtë! Në atë pjesë ka të dhëna të pakuptimta, ku janë identifikuar gabimet të shumta të bëra në dosjen e tenderit ose janë nënshkruar kontrata nga këshilltarët financiar. Komisioni as njëherë nuk ka pranuar një Raport të këtij niveli profesional, dhe kjo është shqetësuese nëse vazhdon trendi i sjelljes së raporteve në këtë formë nga ZAP-i.

Afrim Hoti – Pyeti: a është arsye ndërrimi i shpeshtë i Sekretarit të MASHT-it, për vonesat në implementim të projektit?

Albert Kinolli – Sipas raportit të cilin e kemi nga ZAP me tabela të dhëna të vitit 2012 po shihet se në total prej 350 të diplomuar nëpër shkollë Gjilan, Ferizaj, Pejë dhe Vushtrri, a ka pasur pjesëtarë të komitetit rom, ashkali dhe egjiptas?

Lage Olofsson – ZAP ka kryer auditimin e projektit Danida, i cili projekt ka zgjatur për 4 vite. Së bashku me partnerët që kanë kontribuar në këtë projekt kemi parë një numër sfidash gjatë këtyre viteve dhe për këtë të gjithë partnerët e përfshirë janë munduar të japin dhe t'i adresojnë ato sfida në mënyra të ndryshme. Në këtë e quajmë vlerësim dhe është i njëjtë si auditimi i performancës ku përfshihen më fillim analizat e tjera në perspektivën e të ardhmes. Gjatë kësaj periudhe janë bërë shumë ndryshime për mënyrën se si projekti është mbikëqyrur menaxhuar dhe ekzekutuar Po ashtu rekomandimet u janë drejtuar edhe donatorëve, por edhe Qeverisë. Në të ardhmen janë duke ardhur 2 projekte të rëndësishme në fushën e Pylltarisë dhe në fushën e Arsimit.

Për ZAP-in ishte një detyrë e veçantë apo një delegim i veçantë e cila përmban në vete dy detyra: Të analizohen ngecjet dhe vështirësitë në implementimin e programit sipas regjimit të financave publike në Kosovë si dhe nxirrja e konkluzioneve për projektet e tjera. Kjo është ajo çka kemi bërë. Ne nuk mund të diskutojmë për çështje të cilat janë jashtë fushëveprimit apo jashtë detyrës. Pra kjo është gjëja e parë ashtu siç tha edhe Lars opinionet e më hershme në auditimet e rregullsisë së pasqyrave financiare dhe shumat mund të gjenden në ato raporte të auditimit dhe raporti më i fundit i auditimit për vitin 2012. Po ashtu me 8 maj 2013 do të diskutohet në takimin e komitetit drejtues të projektit.

Lars Ranfelt përfaqësues i DANIDA-së - Nga periudha e fillimit që nga viti 2008 e deri në 2012, projekti „Danida” ka shpenzuar 1.8 milion euro dhe për pjesën tjetër të këtij viti për vitin 2013, ne po ashtu do të shpenzojmë edhe 1.8 milion euro. Është një shumë e madhe për këtë vit, por kjo është për shkak të vonesave. Pra shumë prokurime i kemi bartur i kemi zhvendosur për këtë vit dhe tani me ndihmën e AQP-së mendojmë që ne do të arrijmë që të fitojmë dhe t'i realizojmë të gjitha këto prokurime të vonuara. Këtë vit siç jeni të informuar shkolla në Gjilan është dashur shumë kohë për tu finalizuar. Tani pritet pagesa e një shume prej 390 mijë euro

nga ana e Danidas dhe gjithashtu Komuna e Gjilanit ka paguar 200 mije euro.

Fikrije Gjimberi, Danida – Në kuadër të 4 shkollave që ne i kemi në mbështetje, janë të tipit të lëmis së bujqësisë. Në kuadër të këtyre shkollave janë të krijuara qendrat në shërbime të nxënësve dhe kjo ndërlidhet me përqendrueshmërinë e projektit për krijime këtyre Qendrave. Na kemi bërë marrëveshje me Kryetarët e Komunave si dhe me drejtorët e Arsimit, që njerëz që punojnë aty kanë detyra dhe përgjegjësi të caktuara. Nëse njëri punon me gjysmë norme sepse ka qenë problem buxheti për të inkuadruar mësimdhënës të ri dhe për atë janë zgjedhë ata që kanë pasur gjysmë norme që të paguhen deri në fund të programit 50% nga donatorët dhe 50% komuna. Ka person që është përgjegjës për udhëzimet në karrierë që realizon fushata informative, organizon tryeza, takim me prindër dhe është personi tjetër përgjegjës për të mbajtur lidhjen në mes të shkollës dhe sektorit të biznesit që ka përforcuar. Shumë nxënës bazë të përfundimit janë punësuar pas diplomimit dhe asnjëherë nuk ka pas një bazë të të dhënave se çfarë ndodh me nxënësit pasi që ata që e përfundojnë shkollimin në kuadër të këtyre shkollave. Ka një sistem informativ për tregun e punës ku janë baza e të dhënave në relacion me tregun e punës, sa nxënës janë të punësuar gjatë shkollimit, e sa janë të punësuar pas shkollimit dhe sa janë të orientuar në arsimin e lartë. Përmes programit kemi bërë një transferim të fondeve në kuadër të këtyre shkollave për të parë se si shkollat janë të afta për të menaxhuar këto fonde, ku një pjesë e këtyre fondeve është dedikuar për pagesë të mësimdhënësve. Jemi dakorduar po ashtu që këta mësimdhënës janë futur në sistemin e pagave me normë të plotë që ju takon mësimdhënësve dhe komuna vazhdon t'i mbajë këta mësimdhënës në kuadër të qendrave. Kjo tregon qëndrueshmërinë. Nuk kemi pas pjesëtarë të minoriteteve. Përveç shoqatës “Raje” që është ndihmuar nga projekti Danida, ku i është dhuruar një serë dhe Motorkultivatorë.

Mursel Haljilji – Theksoi se nuk është instrument matës se sa nxënës kanë diplomuar në këto shkolla dhe se sa është numri i mësimdhënësve të angazhuar në këto shkolla. Mendoj se zyrtarët e projektit duhet ta kenë një të dhënë reale se sa të rinj kanë filluar t'i qasen sektorit të bujqësisë dhe se cilat janë të arriturat në këtë sektorë nga këta të rinj dhe se sa ka ndikuar projekti në joshjen e të rinjve në këtë sferë mjaftë të rëndësishme.

Ramë Buja, Ministër – Përmes këtij projekti janë arritur rezultate të dukshme në këtë drejtim. Dua të theksoj se janë ndërtuar 2 shkolla profesionale bujqësore në Ferizaj dhe në Vushtrri si dhe është bërë ndërtimi i shkollës së re në Gjilan e cila pritet të funksionalizohet me 8 maj 2013. Programi Danida ka realizuar 4 shkolla bujqësore dhe programi ka mbështetur ngritjen e serës për minoritetin serb. Shkolla Bujqësore me seli në Partesh, me sipërfaqe prej 200 metra katror që do t'ju shërbej nxënësve për kryerjen e punëve praktike si dhe përfituesi i „Serës” me 70 metra katrorë është komuniteti Rom, Ashkali edhe Egjiptas në Prizren. Programi ka mbështetur edhe shoqatën e grave me seli në Drenas, me pajisje për përpunimin e pemëve dhe perimeve për produktin final dhe në kuadër të kësaj shoqata të rregullta janë 27 anëtarë ku shumica prej tyre janë femra. Funksionimi i firmave virtuale në Ferizaj, Vushtrri dhe Pejë paraqet përfshirjen me sukses të tri shkollave ku 95% e nxënësve janë përfshirë në punën praktike në kuadër të këtyre firmave. Përparësi e këtyre firmave është se nxënësit kanë mundësi që produktet t'i provojnë të bëjnë blerje dhe shitje virtuale dhe në anën tjetër të shesin produkte në bazë të rregullativës.

Nga viti 2008 e gjerë në vitin 2013, për 17.7% është shtuar efektshmëria e shkollimit, por edhe e punësimit. Ndërsa, në vitin 2012 kanë mbaruar shkollimin 350 nxënës dhe vetëm 47 prej tyre nuk janë punësuar deri tani. Po ashtu një e dhënë ku në vitin 2007 kanë qenë të regjistruar në shkolla bujqësore 2015, nxënës ndërsa në vitin 2011, ky numër është rritur në 2386.

Kryetari – ZAP të përgatisë një raport të veçantë pas përfundimit të projektit dhe për këtë të e njofton Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, të përgatisë një raport të veçantë pas përfundimit të projektit dhe për këtë të e njoftoj Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike.

4. Shqyrtimi i propozimit të deputetes Valbona Dibra, lidhur me kërkesën për Raport nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për menaxhimin e stafit në këtë institucion

Imri Ahmeti - Propozoi që Komisioni ta shtyj shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës për një mbledhje tjetër të Komisionit.

Ramiz Lladrovci – Nuk u pajtua me propozimin e deputetit Ahmeti. Komisioni sot ka votuar rendin e ditës, po ashtu edhe në mbledhjen e kaluar është votuar për këtë dhe deputetët nëse kanë angazhime mund të largohen nga mbledhja, por Komisioni duhet të vazhdoj me punën.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nga gjithsejtë 9 deputet të pranishëm, me 1 votë për, 8 kundër, asnjë abstenim, nxori këtë

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, vazhdon mbledhjen me shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Kryetari – Ishte i mendimit se kjo çështje mund të keqinterpretohet si ndërhyrje në punën e agjensoneve të pavarura. Sipas mendimit të Departamentit Ligjor ZAP, raportin në Kuvend për veprimtarinë e vet dhe në kuadër të kësaj Komisioni mund të kërkoj informata në nuanca të caktuara. Te kërkojmë raport të veçantë ne nuk e kemi këtë të drejtë. Dhe ky është mendim i zyrës juridike, Por, pasi që të marrim Raportin vjetor të veprimtarisë së ZAP-it, mund të lëshohemi në informacione shtesë.

Valbona Dibra – Falënderoi Departamentin Ligjor të Kuvendit i cili ka vlerësuar drejtë kërkesën time, për Raport me shkrim nga ZAP-i, për menaxhimin e stafit, ku revoltën e këtij keqmenaxhimi sindikata ia ka shprehur auditorit. Realisht Komisioni nuk është dashur të kërkoj mendim ligjor, sepse askush nuk mund t'ia cungoi të drejtën këtij Komisioni për të kërkuar informata. Ne kemi të drejtë dhe kemi kërkuar informata dhe do të kërkojmë nga çdo institucion. Kërkesa legjitime që tashmë është konfirmuar. Personalisht nuk e kuptoj përse është dashur të kaloj nëpër tërë këtë procedurë, por insistimi i vazhdueshëm i kryetarit në tri mbledhjet e kaluara, që kërkesa ime të mos shqyrtohet, len vend për dyshim. Letra e sindikalistëve drejtuar menaxhmenit është arsyeja kryesore pse unë kam kërkuar dhe kërkoj sqarim me shkrim nga Auditori i Përgjithshëm. Shqetësimet në letrën e sindikatës janë shqetësime me bazë dhe shumë shqetësuese dhe për këtë arsye por kërkoj sqarim me shkrim. Përgjigjja e Auditorit të Përgjithshëm në raport me letrën e sindikatës e ka përforcuar edhe më shumë bindjen time për mënyrën e si ai menaxhon me stafin. Me këtë ai ka shantazhuar sindikatën duke ditur që sindikata ka mbi 100 anëtarë. Mos menaxhimi i mirë me stafin ka rezultuar me vetëm dy raporte të performancës edhe pse KMFP vazhdimisht ka bërë kërkesë dhe bënë kërkesë për raporte të performancës. Dëshmi për këtë është raporti të dobët që diskutuam sot në Komision në pikën tre të rendit të ditës. ZAP i është përgjigjur me raport me shkrim lidhur me ristrukturimin e stafit sa herë këtë e ka kërkuar Komisioni.

Propozimi im ishte informatë me shkrim nga Auditori i Përgjithshëm lidhur me menaxhimin e stafit konkretisht të auditorëve. Anëtarët e Komisionit kane pasur hezitime se nuk kanë informata. Anëtarët e Komisionit po e kufizojnë vetën për të pasur informata, sepse unë pikërisht po kërkoj informata nga ZAP. Personalisht jam për përforcimin e ZAP-it, sepse është

institucioni më i lartë për kontrollin e parasë publike dhe të taksapagueseve. Vazhdoj të jem me moton që “një cent i vjedhur apo i keqpërdorur gabimisht është vjedhje ndaj një të varfëri”.

Afrim Hoti – U interesua, nëse Komisioni ka të drejtën që të kërkoj nga ZAP-i raport me shkrim, atëherë pse Komisioni nuk ka të drejtën ta bëjë këtë me të gjitha ministritë dhe institucionet e tjera.

Kryetari – Komisioni ka kërkuar nga Institucionet e tjera plan veprimi, nëse e ka vlerësuar sipas të gjeturave të raportit të auditimit. Çështja e ZAP-it është specifike. Çështja për të cilën po debatohet sot duhet të trajtohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, në të kundërtën trajtimi i kësaj çështjeje në Komision, është ndërhyrje në pavarësinë e ZAP-it. Personalisht ishte i mendimit se kërkesa bie jashtë fushës së përgjegjësi të Komisionit. Raportin vjetor bashkë me raportin e auditimit, Komisioni do ta ketë. Nëse Komisioni nxjerr diçka që mendon që duhet hulumtuar, atëherë Komisioni angazhon ekspert të jashtëm dhe analizon çështjen. Nuk dua që të ndihet presion ZAP-i se po ndikohet në punën e tij, dhe po kërkohet t'i mbyllet goja një institucioni të pavarur. E njëjta gjë është thënë edhe nga Departamenti Ligjor.

Ramiz Llandrovci – Tha se shqetësimet e deputetes Dibra, nuk përfshihen në raportin e vitin 2012, por në atë të vitit 2013> Pyeti: a mundet Auditori i Përgjithshëm të na sjellë informatë me shkrim lidhur me këto probleme? Komisioni po kërkon një informatë lidhur me shqetësimet brenda vitit 2013. kërkoi mendimin e auditorit të përgjithshëm lidhur me këtë.

Adem Grabovci – Përsëritet punën e Auditorit të Përgjithshëm dhe profesionalizmin e treguar. Auditori do ta kuptoj në mënyrë korrekte kërkesën e deputetes, sepse Auditori i Përgjithshëm nuk do të jetë në vazhdimësi apo përjetësisht në Kosovë. Suksesi i tij është që kjo zyrë të arrij të përgatisë stafin për të marrë obligime dhe përgjegjësi të tjera. Kërkoj nga Auditori që të na jep informatë se deri kur ka arritur me përgatitjen e stafit vendor dhe sa janë të gatshëm ata me profesionalizëm për të menaxhuar me këtë zyrë.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka rëndësi shumë të madhe, na ndihmon të korrigjohemi dhe të evitojmë ngecjet tona. Është shumë më rëndësi që të njihen dobësitë, të cilat pastaj do t'i korrigjojmë me angazhimin ton, duke gjetur forma dhe mjete.

Kryetari duhet të respektoj rregulloren dhe është në përgjegjësinë e tij që të mos i jap ngjyime politike, është i obliguar që të ruaj balancën dhe nuk guxon të na akuzoj “që duam t'i mbyllem gojën auditorit”. Më ngjyime politike nuk gëzojmë të flasim sepse bashkëpunimi në këtë Komision deri tani ka qenë i mrekullueshëm Ky diskutim duhet të merret si gatishmëri për të përkrahur auditorin për punë profesionale.

Si anëtarë i këtij Komisioni, pa pasur pretendime t'i jap ngjyra politike sepse këtu përfaqësoj interesat e shtetit, dhe sipas mendimit të departamentit ligjor ku thuhet “Raporti për veprimtarinë e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, përveç tjerash përmban edhe informata për Burime njerëzore (stafin, rekrutimin, trajnimet dhe zhvillimet si dhe vlerësimin e stafit). Bazuar në këtë, Komisioni mban të drejtën që të pres afatin ligjor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për Raportim para Kuvendit, apo të kërkoj informata paraprakisht për çështje me interes për Komisionin”, kërkova informata nga Auditori i Përgjithshëm, në mënyrë që të hiqen dilemat. Kërkesa e sindikalistëve nuk duhet marrë si tendencioze - nuk dua të merrem me këtë - por ne na duhet të kemi informata për stafin se sa është i përgatitur për të marrë përgjegjësi në këtë zyrë.

Ky Komision ka të drejtë të kërkoj sqarime nga çdo institucion. Personalisht kam kërkuar që të jemi më këmbëngulës dhe të kërkojmë llogaridhënie.

Propozoi që ZAP në fund të muajit të sjell raportin e performancës në këtë Komision, i cili raport i përfshinë të gjitha interesimet e Komisionit. Personalisht më intereson se sa ka arrit stafi vendor të përgatitet për të marrë përgjegjësi.

Lars Lage Olofsson – Mendoj që është shumë mirë që ZAP është analizuar në këtë mënyrë.

Nuk kam asgjë kundër kësaj. Mendoj që është mirë që të kemi një takim që i dedikohet kësaj, i cili mund ta ketë një bazë dhe kjo bazë është Raporti vjetror i performancës, të cilin do ta keni në fund të muajit. Ky Raport do të ketë edhe mendimin e auditorit të jashtëm i zgjedhur nga Kuvendi. Pastaj do të kishit shansin që gjatë këtij takimi të diskutoni edhe kornizë afatmesme të shpenzimeve. Në atë takim do të diskutohen këto tri dokumente, ku do të paraqiten edhe këto shqetësime dhe aty paraqiten edhe se si do të adresohen shqetësimet deri në vitin 2014, si dhe prioritetet domethënë nuk ka të bëjë vetëm me paratë.

Valbona Dibra - Asnjëherë nuk kemi ndërhyrë në pavarësinë e ZAP. Deri sot asnjëherë nuk kemi ndërhyrë në këtë punë. Por ne si Komision kemi të drejtë për të kërkuar informacione, këtë e kemi bërë edhe kur është diskutuar riorganizimit të ZAP.

ZAP me Kushtetutë dhe Ligj është i obliguar të raportoj në Kuvend. Propozoi që të votohet propozimi im, pastaj me vota do të vendoset si do të veprohet më tutje. Sipas Ligjit auditori është i obliguar të dorëzoj Raportin e performancës ku përfshihet edhe opinioni i auditorit. Shqetësimet janë ngritur në vitin 2013, edhe pse këto datojnë që nga viti 2012. Letra e sindikatës ka dalë në vitin 2013. Komisioni është për forcimin e zyrës dhe funksionalizimin e plotë të saj, dhe mbi këtë bazë ka dalë propozimi im.

Kryetari – Tha se Komisioni do ta marrë Raportin nga ZAP dhe në kuadër të saj do të diskutojë të gjitha shqetësimet, por jo ato të sindikatës sepse kjo nuk është objekt diskutimi. Kemi dy propozime për të votuar.

Kryesuesi ftoi anëtarët e Komisionit për të votuar lidhur me propozimin e deputetes Dibra.

Bali Muharremaj – Propozoi që Komisioni të votojë dhe vota të jetë ajo e cila do të përcaktoj nëse Komisioni do të kërkojë informatë të veçantë apo të presë Raportin vjetror të performancës.

Ramiz Lladrovci – Nuk kemi të bëjmë me dy propozime. Para se çështja të qitet në votim duam të sqarojmë se nëse Auditori i Përgjithshëm do të përfshijë edhe interesimet tona në raport të performancës ne mund të presim, por këtë duhet të na sigurojë Auditori. Sepse, shqetësimet tona janë në vitin 2013. Nuk janë në pyetje vetëm trajnimet e stafit. Kërkesa e deputetes përfshinë diçka tjetër. Komisioni duhet të votojë nëse ZAP duhet të dorëzojë raport të veçantë apo jo?

Adem Grabovci – Ndau mendimin me Auditorin e Përgjithshëm, që të pritët Raporti i performancës së ZAP-it i cili do të jetë në Kuvend në fund të këtij muaji. Në kuadër të kësaj do të përfshihen të gjitha.

Kryetari ftoi në votim deputetet për propozimin e deputetes Dibra, për informatë të veçantë nga ZAP.

Valbona Dibra – Tha se para se të votohet duhet të sqarojë. Nëse Auditori i Përgjithshëm përfshin edhe shqetësimet e saj, atëherë mund të presim Raportin e performancës.

Kryetari - Kush është kundër propozimit të deputetes Dibra?

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nxori këtë

Përfundim

Auditori i Përgjithshëm në Raportin e performancës duhet të përfshijë edhe interesimet e anëtarëve të Komisionit, lidhur me menaxhimin e stafit në këtë Institucion.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu